### ❖ Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën

Në Bashkia Maliq, ankesat regjistrohen pranë protokollit zyrtar dhe shqyrtohen nga koordinatori për të drejtën e informimit dhe koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse sipas objektit të ankesës.

Përcaktimi dhe funksionimi i koordinatorit për të drejtën e informimit mbështetet në Ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", konkretisht:

a) *neni 10, i cili parashikon detyrimin e autoritetit publik për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit;*

b) *neni 11, që përcakton kompetencat e koordinatorit për trajtimin e kërkesave dhe ndjekjen e procedurave administrative të informimit.*

Ndërsa koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik mbështetet në Ligji nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", konkretisht:

a) neni 10, i cili parashikon caktimin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik;

b) neni 18 dhe neni 19, që lidhen me administrimin, shqyrtimin dhe evidentimin e komenteve, rekomandimeve dhe procedurave të konsultimit publik.

Struktura përgjegjëse në Bashkia Maliq:

a) *administron dhe regjistron ankesën;*

b) *verifikon dokumentacionin shoqërues;*

c) *ndjek afatet procedurale të trajtimit;*

d) *koordinon shqyrtimin administrativ të ankesës me strukturat kompetente;*

e) *përgatit kthimin e përgjigjes administrative ndaj ankuesit;*

f) *evidenton masat për përmirësimin e transparencës dhe konsultimit publik;*

g) *administron dokumentacionin dhe raportimin përkatës sipas legjislacionit në fuqi.*